

Nr. 1548/18 Prot

Durrës, më: 18.06.2025

V E N D I M

Nr. 77, datë 18.06.2025

PËR

“RIORGANIZIM NËN MASËN 20% TË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL 2- VJEÇAR NË “TEKNOLOGJI AUTOMOBILASH”, PRANË FAKULTETIT TË STUDIMEVE PROFESIONALE, TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës”

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar; Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”; në Statutin e UAMD; Rregulloren e UAMD; si dhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 1469/1 prot., datë 16.06.2025, në mbledhjen e datës 18.06.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e riorganizimit nën masën 20% të programit të studimit me karakter profesional 2- vjeçar në “Teknologji Automobilash”, pranë Departamentit të Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët,

- Drejtuesi i Njesisë Kryesore,
 - Drejtuesi i Njesisë Bazë,
 - Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

